



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:240605

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06325400

Ac.nr.5523/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët: Naime Ahmeti kryetare e kolegjit, Qerim Ademaj dhe Adnan Konushevci, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses V.K.A. nga Prishtina, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit A.S., Avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Ministria e Financave, me seli në Prishtinë, dhe Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, me objekt të padisë anulimi i vendimit Nr. 48/2018 i Ministrisë së Financave, i datës 17.06.2018 dhe anulim i konkursit të brendshëm nr. 05.6.1/1068, i datës 08.06.2018 i Doganës së Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të autorizuarit të paditëses, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë– Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3381/2018 të datës 01.04.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 11.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet e pathemeltë ankesa e paditëses V.K.A. nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë– Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.3381/2018 i datës 01.04.2021, vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.3381/2018 të datës 01.04.2021, në pikën një të dispozitivit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses V.K.A., nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që “të anulohet vendimi nr. 43/2018 i të paditurës së parë Ministria e Financave me nr. protokoli 01/1706-2 i datës 17.06.2018 si dhe konkursi i brendshëm nr. 05.6.1/1068 i shpallur me datën 08.06.2018 nga Dogana e Kosovës, si dhe të obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Doganës së Kosovës të rishpall konkursin e brendshëm duke i eliminuar të metat e konstatuara gjatë zhvillimit të procedurës së konkursit të brendshëm nr. 05.06.1/1068, i datës 08.06.2018. Në pikën dy të dispozitivit ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Me aktvendimin C.nr.3381/18 të datës 25.05.2021, ka vendosur për korrigjimin e aktgjykimi C.nr. 3381/18 të datës 01.04.2021, si vijon:

‘I.KORRIGJOHET Aktgjykimi C.nr. 3381/18 i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, i datës 01.04.2021, ashtu që në hyrje të këtij aktgjykimi si dhe në dispozitivin e të njëjtit, tek emri i paditëses, në vend të emrit V.K.A. duhet të jetë emri V.K.A.

II.Pjesa tjetër e Aktgjykimit C.nr. 3381/18, i datës 01.04.2021, mbetet e pandryshuar.

III.Ky aktvendim është pjesë përbërëse e Aktgjykimit C.nr. 3381/18, i datës 01.04.2021’’.

Kundër aktgjykimit C.nr. 3381/18 të datës 01.04.2021, në afatin e paraparë ligjor ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditëses, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit të aprovoj ankesën e paditëses, të prish aktgjykimin e atakuar dhe lëndën ta kthej në rigjykim.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja, nëpërmes të autorizuarit të saj, në gjykatën e shkallës së parë, ka ushtruar padi me datë 17.10.2018, kundër të paditurës Ministria e Financave, me seli në Prishtinë, për anulimi e vendimit Nr. 48/2018 të datës 17.06.2018 dhe të paditurës Dogana e Kosovës, për anulim i konkursit të brendshëm nr. 05.6.1/1068 të datës 08.06.2018.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditëses, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqës, si dhe vlerësimit të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses dhe ka vendos si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, në arsyetim të tij i është referuar nenit 6, paragrafin 2, të Kodit Doganor, nenit 5, paragrafi 3 i Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 6, i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, ndërsa vendimin mbi shpenzimet procedurale e ka bazuar në nenin 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së dhe drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditëses për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që me rastin e hartimit të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë në tërësi ka

zbatuar nenin 160 të LPK-së, pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i kjtartë dhe i kuptueshëm. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendos si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, edhe gjendja faktike në këtë procedurë është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë ku mbi bazën e kësaj gjendje edhe është refuzuar kërkesëpadia e paditëses, andaj pretendimi ankimor se gjykata nuk e ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike për faktin se nuk e ka marrë për bazë dispozitën e nenit 49 par.7 pika 7.3 të UA nr.37/2016, me të cilin rregullohet marrëdhënia e punës e oficerëve doganar, me rastin e shpalljes së konkursit të brendshëm nr. 05.6.1/1068 nga e paditura Dogana e Kosovës dhe nga ky shkak paditësja është diskriminuar në aspektin gjinor, është i pabazuar sepse me referim të nenit 6, paragrafin 2, të Kodit Doganor, gjykata me të drejtë ka konstatuar se përbërja e komisionit sipas konkursit të brendshëm nr. 05.6.1/1068 të datës 08.06.2018, ka qenë e rregullt sepse komisioni ka qenë i përbërë prej përfaqësuesit udhëheqës të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, përfaqësuesit udhëheqës të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe një përfaqësuesi të doganave, dhe nuk ka qenë kërkesë ligjore përbërja e gjinisë së anëtarëve të komisionit, me çka me të drejtë gjykata ka vlerësuar se nuk ka pasur diskriminim në përbërje të anëtarëve të komisionit, vetëm nga fakti se ka qenë në përbërje të gjinisë së kundërt nga ajo e paditëses, por se përbërja e komisionit ka qenë në kondita ligjore, ndërsa vlerësimi nuk ka pasur të bëjë me gjininë por me kompetencën profesionale sipas kushteve të konkursit për vendin e caktuar të punës dhe arritshmërisë së pikëve të secilit kandidat.

Mbi këtë gjendje faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së dytë e pranon në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë edhe për zbatimin e rregullt dhe të drejtë të dispozitave materialo-juridike, dhe janë të paqëndrueshme pretendimet ankimore me theksin se gjykata e shkallës së parë nuk e ka marrë fare për bazë të UA nr.37/2016 me të cilën përcaktohen kriteret për avancime dhe përshkrimin e vendit të punës, duke e konsideruar si shkelje materiale të gjykatës, sepse në konkurs nuk është shënuar saktë pozicioni i lirë brenda institucionit dhe tek edukimi universitar nuk ka qenë e shënuar e profili përkatës siç përcaktohet me nenin 49, paragrafi 7, pika 7.3 deri te 7.7 i Udhëzimit Administrativ 37/2016, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për pa themelësinë e kërkesëpadisë është i drejtë dhe i bazuar, pasi që duke ju referuar dispozitës së nenit 4, paragrafi 1 të Ligji Nr.03/L-212 i Punës, është paraparë se: *''Dispozitat e Kontratës Kolektive, Aktit të Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratës së Punës duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij ligji''*. Marrë parasysh faktin se konkursi i brendshëm nr. 05.6.1/1068 të datës 08.06.2018, i shpallur nga e paditura e dytë siç u theksua edhe më lartë ishte në harmoni të plotë me nenin 6, paragrafin 2, të Kodit Doganor i cili është ligj special për zyrtarët doganor ndërsa Udhëzimi Administrativ nr.37/2016 në të cilin thirret pala paditëse, është akt nën ligjor për zbatimin e ligjit. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike të vërtetuar dhe në kuptim të dispozitave ligjore të lartë cekura, përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, Ligjit për Barazi Gjinore, dhe dispozitave

tjera ligjore të së drejtës materiale në të cilat është bazuar aktgjykimi i atakuar, ka rezultuar se nuk ka pasur bazë ligjore për anulimin e konkursit nr. 05.6.1/1068 të datës 08.06.2018, dhe detyrimin e të paditurës së dytë Dogana e Kosovës për shpallje të serishëm të njëjtit, aq më pak për anulim të vendimit Nr. 48/2018 të paditurës së parë Ministrisë së Financave, e cila ishte çështje administrative, andaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, për çka edhe ankesa e të autorizuarit të paditëses është refuzuar si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar është vërtetuar, duke vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Meqë aktgjykimi i atakuar është vërtetuar në tërësi, automatikisht vërtetohet edhe vendimi mbi shpenzimet procedurale, për të cilin gjykata me të drejtë është mbështetur në nenin 450, të LPK-së.

Nga të gjitha arsyet e cekura në arsyetim të këtij aktgjykimi të shkallës së dytë, Gjykatës së Apelit i rezulton se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, andaj në mbështetje të dispozitave nga nenet 194, 195, paragrafi 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5523/2021, me datë 11.10.2024

Kryetare e Kolegjit
Naime Ahmeti, d.v